



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 294/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Instituti i Rrjetit Ballkanik të Gazetaris Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterit brenda hapësirave të vendvotimit VV nr.1109b në Komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 294/2017 i datës 12.06.2017 parashtruar nga Instituti i Rrjetit Ballkanik të Gazetaris Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë .

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 12 qershor 2017, nga Instituti i Rrjetit Ballkanik të Gazetaris Hulumtuese (BIRN) në të cilën pretendon se kandidati nga radhët e koalicionit LDK-AKR në afërsi të vendvotimit VV nr. 1109b në Mitrovicë e ka vendosur posterin, prandaj thekson se është shkelur neni 36 paragrafi 1 i LZP-së. Parashtruesi i ankesës në cilësi të provës si dëshmi e ka bashkangjitur një fotografi nga vendi i ngjarjes .

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 dhe 3 i LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se ne afërsi të vendvotimit VV nr. 1109b në Mitrovicë, kandidati nga radhët e koalicionit LDK-AKR e ka vendosur posterin, pra në hapësira të vendvotimit .

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar e ka shkelur heshtjen zgjedhore me vendosjen e posterve në afërsi të vendvotimit. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se vendi se ku gjendet Vendvotimi VV me numër 1109b.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 294/2017 i datës 13.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.